

KËRKESË
Nr.6841/4, datë 5.11.2007

SHPALLJE KËRKESË PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Financave shpall kërkesën për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, të prekura nga ndërtimi i pikës së kalimit kufitar Muriqan, Sukobinë.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Drejtoria e Përgjithshme e Doganave. Me anë të këtij publikimi në shtyp, kërkohet të vëmë në dijeni personat, të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur nga Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit pranë Ministrisë së Financave, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrat në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Financave).

Për të gjithë pronarët që në kolonën shënime në tabelën e publikuar, është bërë shënimi “Plotësim dokumentacioni” do të kompensohen për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave (subjekti kërkues në bazë të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë pronë private për interes publik”).

Për ato pasuri për të cilat është bërë shënimi “Pretendim pronësie, pronarët pretendentë duhet të paraqesin brenda afatit 15-ditor, dokumentacionin respektiv të pronësisë ose konfirmimin nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Shkodër për të vërtetuar titullin e pronësisë, në të kundërt këto pasuri do të përjashtohen nga shpronësimi. Deri në këto momente paratë do të qëndrojnë të bllokuara në bankë.

Vlera totale e këtij shpronësimi është 6 152 500 (gjashtë milionë e njëqind e pesëdhjetë e dymijë e pesëqind) lekë.

Nr.	Emër mbiemër	Njësia	Sasia	Çmimi mesatar	Vlefëta paraprake	Shënime
1.	Esat Guri	m ²	1760	500 lekë	880 000 lekë	Plotësim dokumentacioni
2	Bedri Guri	“	4991	500 lekë	2 495 500 lekë	Plotësim dokumentacioni
3	Xhevahir Fusha	“	1005	500 lekë	502 500 lekë	Pretendim pronësie
4	Meme Fusha	“	468	500 lekë	234 000 lekë	Pretendim pronësie
5	Avni Guri	“	2241	500 lekë	1 120 500 lekë	Pretendim pronësie
6	Syla Guri	“	1000	500 lekë	500 000 lekë	Pretendim pronësie
7	Njazi Guri	“	420	500 lekë	210 000 lekë	Pretendim pronësie
8	Xhevdet Guri	“	420	500 lekë	210 000 lekë	Pretendim pronësie